



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:126555

Datë: 09.06.2022

Numri i dokumentit: 03115589

PKR.nr.65/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, nga Kryetari i Trupit Gjykses – Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit M. (R.) S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 parg.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PP/L.nr.113/2020, të datës 20.04.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar - publik, me datën 06.06.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit së tij av.Driton Dobruna nga Gjakova, sipas autorizimit, **me dt.09.06.2022**, mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

M. S. i lindur me dt..... në Gjakovë, me banim në Rr. “.....” nr...”, nga i ati R. dhe e ëma A., e lindur Q., i pa martuar, i gjendjes së mirë ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme zdrukthetari, shkollën e lartë Hoteleri, me profesion zdrukthuar, me numër personal ID, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e pa vërtetuar gjerë me dt.30.07.2020 rreth orës 10:45 ne Gjakovë në rr. “A. R.” nr..., pikërisht në bodrumin e shtëpisë së tij, pa autorizim ka kultivuar dhe mbajtur substancë narkotike të llojit marihuanë dhe atë me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotrope ashtu që gjatë bastisjes së shtëpisë dhe objekteve tjera përcjellëse në bodrumin e shtëpisë janë gjetur 14 (katërmëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa me gjatësi prej 90 cm deri 160 cm të mbjella në vazo në një dhomë e cila ishte modifikuar si laborator me ndriçim të posaçëm rregullator të rrymës, matës të temperaturës dhe flutura për ajrosje, si dhe në tavanin e kësaj shtëpie janë gjetur 11 (njëmbëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa që ishin në proces të tharjes, ashtu që nga ekzaminimi i kryer i mostrave të kësaj substance narkotike sipas raportit të AKF-së me numër AKF/.....ka rezultuar të jetë e llojit marihuanë.

- Me çka ka kryer veprën penale, kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 parag.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 42, 69, 70, dhe nenit 272 par.1 dhe 2 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej **1 (një) vite, e 6 (gjashtë) muaj**, të cilin dënim i akuzuari duhen ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ndaj të akuzuarit M. S. konfiskohet: 14 (katërbëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa me gjatësi prej 90 cm deri 160 cm të mbjella në vazo, po ashtu konfiskohen pajisjet ndriçimi i posaçëm rregullator të rrymës, matës të temperaturës dhe flutura për ajrosje, si dhe 11 (njëmbëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa, si objekt i veprës penale.

Detyrohet i akuzuari M. S., që t'i paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100 (njëqind) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.113/2020, të datës 20.04.2022, kundër të akuzuarit M. (R.) S. nga Gjakova, për shkak të veprës penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 parag.1 të KPRK-së.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj – Hyseni, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë akuzës duke i propozuar Gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

I akuzuari M. S., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ka shtuar se është penduar për veprën e kryer, i premtos gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla penale, duke i propozuar gjykatës që të ketë parasysh një dënim sa më të lehtë.

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj-Hyseni duke dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e

këtu të pandehurit, meqenëse i njëjti edhe në prokurori e ka pranuar fajësinë, pasi i njëjti i kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë me vetëdije dhe vullnet të plotë si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat në të cilat mbështetet edhe aktakuza, i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit M. S., av.Driton Dobruna nga Gjakova, duke dhënë mendimin lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se gjithashtu edhe ne si mbrojtje kërkojmë nga gjykata që ta aprovojë pranimin e fajësisë pasi që ky pranim është në përputhje me dispozitat e KPPK-së si dhe në konsultimet e mjaftueshme me mua si mbrojtës, ky pranim i fajësisë së bërë nga i njëjti është paraqitje e sinqeritetit të tij, pendimit të thellë, i cili i premtojë gjykatës që nuk do të përsërisë vepra të tilla, është i turpëruar për veprën e kryer, ka qenë një ndër momentet më të vështira në jetën e tij dhe këtë veprim e ka bërë në naivitet të plotë pa i menduar pasojat e veprimeve të tij, ka qenë vetëm në shtëpi, i mërzhitur gjithashtu është hera e parë që ballafaqohet me drejtësinë dhe duke parë që minimumi i kësaj vepre është 1 vit atëherë kërkojmë nga gjykata që të ketë parasysh një dënim sa më atë butë, po e marrë guximin dhe po kërkojë për shkak të gjendjes së tij të mirë ekonomike, ti shqiptojë një dënim me gjobë sa do i madhe që të jetë, i njëjti do të mund të përballonte, ku do të përfitonte edhe shtetit i Kosovës, lartësia e gjobës nuk është me rëndësi, sado që ti shqiptojë gjykata ne do të jemi në gjendje që ta paguajmë menjëherë brenda afatit ligjor, andaj lus gjykatën që të ketë parasysh që dënimi të jetë sa më i vogël ose me gjobë e cila do të arrinte qëllimin e vet, i cili është i paraparë me KPRK-në.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.Driton Dobruna, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari M. S., me dashje ka kryer veprën penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit nga neni 272 parag.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 272 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale kultivimi i bimës së hashashit, shkurren së kokainës ose bimëve të kanabisit e kryen *“Kushdo që pa autorizim kultivon bimën e hashashit, shkurren e kokainës ose bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikëve ose substancave psikotrope,, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet”*.

5. Vendimet e kryetarit të trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, kryetari i trupit gjykues të akuzuarin M. S., e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 272 par.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që edhe të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit M. S., gjykata ka shqyrtuar rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit dhe se: jeton veti gjashti në familje, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës dhe në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, si dhe faktin se nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërsa si rrethana rënduese Gjykata ka vlerësuar se i njëjti ka krijuar laborator për narkotikë dhe ka marrë parasysh rrezikshmërinë kësaj vepre penale, ndërsa duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim si i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi

Përveç dënimit kryesor, gjykata ndaj të akuzuarit, ka bërë edhe konfiskimin 14 (katërbëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa me gjatësi prej 90 cm deri 160 cm të mbjella në vazo, po ashtu konfiskohen pajisjet ndriçimi i posaçëm rregullator të rrymës, matës të temperaturës dhe flutura për ajrosje, si dhe 11 (njëmbëdhjetë) bimë narkotike kanabis sativa, si objekte të veprës penale në kuptim të nenit 272 par.2 të KPRK-së

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata ka vendosur që të akuzuarit ti detyrojë për ta paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.65/22, me datë 09.06.2022

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.